## *PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR*

| | 31 Dhjetor 2023 | 31 Dhjetor 2022 |
|---|---|---|
| AKTIVET | | |
| I. Aktivet Afatshkurtra | | |
| Mjete monetare | 2,733,126 | 780,077 |
| Llogari te arketueshme | 29,222,794 | 1,901,486 |
| Të tjera të drejta afatshkurtra | 11,538,581 | 18,147,889 |
| Kapital I nenshkruar I papaguar | 40,000,000 | 40,000,000 |
| Inventarët | | |
| **Totali I aktiveve afatshkurtra** | **83,494,501** | **60,829,452** |
| **II. Aktivet afatgjata** | | |
| Te drejta arketueshme nga qiraja financiare | 195,625,455 | 280,445,109 |
| Aktive jo-materiale | | |
| Aktive tatimore të shtyra | | |
| **Totali I aktiveve afatgjata** | **195,625,455** | **280,445,109** |
| **TOTALI I AKTIVEVE** | **279,119,956** | **341,274,561** |
| **DETYRIMET** | | |
| **I. Detyrimet afatshkurtra** | | |
| Detyrime ndaj institucioneve te kredise | 52,317,101 | 57,119,458 |
| Aktetime ne avance | 16,686,832 | |
| Llogari te pagueshme | 11,936,886 | 15,583,856 |
| Të pagueshme ndaj punonjësve | 307,283 | 63,017 |
| Të pagueshme për detyrime tatimore | 811,584 | 250,470 |
| Të tjera detyrime afatshkurtra | 6,630,267 | 75,635 |
| **Totali I detyrimeve afatshkurtra** | **88,689,953** | **73,092,436** |
| **II. Detyrime afatgjata** | | |
| Detyrime te pagueshme per qera financiare AGJ | 117,369,337 | 197,406,933 |
| Borxh i varur | 9,000,000 | 9,000,000 |
| Të tjera detyrime afatgjata | | |
| Provizione | | |
| Borxh i varur | | |
| **Totali I detyrimeve afatgjata** | **126,369,337** | **206,406,933** |
| **Totali I Detyrimeve** | **215,059,290** | **279,499,369** |
| **III. Kapitali dhe Rezervat** | | |
| Kapitali I Nënshkruar | 63,461,684 | 63,461,684 |
| Rezerva të tjera | | |
| Fitimi I pashpërndarë | (1,686,492) | (2,404,876) |
| Fitim (humbja) e vitit | 2,285,474 | 718,384 |
| **Totali I Kapitalit** | **64,060,666** | **61,775,192** |
| **TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT** | **279,119,956** | **341,274,561** |

ANTIGONE FINANCIAL ENTERPRISE M03... TIRANA- ALBANIA

*PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE*

| | Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2023 | Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2022 |
|---|---|---|
| Te ardhurat nga aktiviteti kryesor | 26,345,790 | 24,918,052 |
| Te ardhura nga interesat | 16,481,898 | 9,607,553 |
| Te ardhurat nga rifaturim primi dhe komisionet | 9,863,892 | 15,310,499 |
| Shpenzimet nga aktiviteti kryesor | (16,802,647) | (13,683,047) |
| 1.Shpenzime nga rifaturim primi | (7,314,800) | (6,846,147) |
| 2. . Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme | (9,487,847) | (6,836,900) |
| Shpenzime të personelit | | |
| 1. Paga dhe shpërblime | (7,393,387) | (8,297,859) |
| 2. Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetsore | (979,450) | (981,608) |
| Shpenzime per provigjione | (2,243,860) | |
| Shpenzime konsumi dhe amortizimi | | |
| Shpenzime të tjera shfrytëzimi | (4,723,320) | (3,941,827) |
| **Fitimi (humbja) nga veprimtaritë e shfrytëzimit** | **(5,796,874)** | **(1,986,289)** |
| Të ardhura të tjera | | |
| 1. Të ardhura nga njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse | | |
| 2. Të ardhura nga investimet dhe huatë e tjera pjesë e aktiveve afatgjata | | |
| 3. Interesa të arkëtueshëm dhe të ardhura të tjera të ngjashme | | |
| Zhvlerësimi i aktiveve financiare dhe investimeve financiare të mbajtura si aktive afatshkurtra | | |
| Shpenzime financiare | | |
| 1. Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme | | |
| 2.Diferencat (+/-) nga perkthimi i monedhes ne veprimtari te huaj | 8,988,778 | 2,704,673 |
| **Fitimi (humbja) para tatimit** | **3,191,904** | **718,384** |
| Shpenzimi i tatimit mbi fitimin | | |
| 1. Shpenzimi i tatim fitimit të periudhës | | |
| 2. Shpenzimi i tatim fitimit të shtyrë | (906,430) | |
| 3. Pjesa e tatim fitimit të pjesëmarrjeve | | |
| **Fitimi (humbja) neto e vitit** | **2,285,474** | **718,384** |
| Te ardhura te tjera gjitheperfshirese per vitin | | |
| Diferencat (+/-) nga perkthimi i monedhes ne veprimtari te huaj | | |
| Diferencat (+/-) nga rivlersimi i aktiveve afatgjata materiale | | |
| Diferencat (+/-) nga rivlersimi i aktiveve financiare te mbartura per shitje | | |
| Pjesa e te ardhurave gjitheperfshirese nga pjesemarrjet | | |
| Totali i te ardhurave te tjera gjitheperfshirese per vitin | | |
| **Totali i te Ardhurave Gjitheperfshirese per vitin** | **2,285,474** | **718,384** |

ANTIGONE FINANCIAL ENTERPRISE TIRANA- ALBANIA

## *PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE*

| *(metoda indirekte)* | Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2023 | Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2022 |
|---|---|---|
| I. Fluksi I Mjeteve Monetare nga / perdorur ne aktivitetin e shfrytezimit | | |
| Fitim/ Humbja e periudhes | 2,285,474 | 718,384 |
| Ndryshime ne aktivet dhe detyrimet e shfrytezimit: | | |
| *Renie / (rritje) ne te drejtat e arketueshme dhe te tjera* | (20,712,000) | (16,256,382) |
| *Renie / (rritje) ne inventare* | - | - |
| *Rritje / (renie) ne detyrimet e pagueshme* | 20,155,608 | 6,569,838 |
| *Rritje / (renie) ne detyrimet per punonjesit* | 244,266 | (365,387) |
| *Rritje / (renie) ne detyrimet e tjera* | | |
| Mjete monetare nga / perdorur ne aktivitetin e shfrytezimit | 1,973,348 | (9,333,547) |
| II. Fluksi I Mjeteve Monetare nga / perdorur ne aktivitetin e investimit | | |
| *a. Renie ne te drejtat e arketueshme nga qeraja financiare* | 84,819,654 | (149,912,506) |
| *b. Para te arketuara nga shitja e filialeve (shuma neto)* | | |
| *c. Pagesa per blerjen e aktiveve afatgjata materiale* | | |
| *d. Arketime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale* | | |
| *e. Pagesa per blerjen e investimeve te tjera* | | |
| *f. Arketime nga shitja e investimeve te tjera* | | |
| *g. Dividende te arketuar* | | |
| Mjete monetare nga / perdorur ne aktivitetin e investimit | 84,819,654 | (149,912,506) |
| III. Fluksi I Mjeteve Monetare nga / perdorur ne aktivitetin e financimit | | |
| *a. Arketime nga emetimi I kapitalit* | - | 3,461,684 |
| *b. Arketime nga borxh I varur* | | 9,000,000 |
| *c. Pagese e detyrimeve te qirase financiare* | (79,538,527) | 87,224,989 |
| *d. Pagesa e kostove te transaksionit qe lidhen me kredite dhe huate* | - | - |
| *e. Interes I paguar* | (9,487,847) | (6,836,900) |
| *f. Pagesa e aksioneve te perdorura si kolateral* | - | |
| *g. Pagesa e huave* | (4,802,357) | 57,119,458 |
| *h. Pagese e detyrimeve te qirase financiare* | | |
| *i. interes I paguar* | | |
| *j. Dividende te paguar* | | |
| Mjete monetare nga / perdorur ne aktivitetin e financimit | (93,828,731) | 149,969,231 |
| IV. Rritja/(pakesimi) neto i mjeteve monetare | (7,035,729) | (9,276,822) |
| V. Mjetet monetare ne fillim te periudhes | 780,077 | 7,352,226 |
| Efekti i luhatjeve te kurseve te kembimit te mjeteve monetare | 8,988,778 | 2,704,673 |
| VI. Mjetet monetare ne fund te periudhes | 2,733,126 | 780,077 |

ANTIGONE FINANCIAL ENTERPRISE
M01329034A TIRANA-ALBANIA

| | Kapitali i nënshkruar | Rezerva të tjera | Fitimet e Pashpërndara | Fitim / Humbja e vitit | Totali |
|---|---|---|---|---|---|
| **Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2021** | ######### | - | (2,040,774) | (364,102) | 57,595,124 |
| Efekti i ndryshimeve në politikat kontabël | | | | | - |
| **Pozicioni financiar i rideklaruar më 1 janar 2022** | ######### | - | (2,040,774) | (364,102) | 57,595,124 |
| **Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:** | | | | | - |
| Fitimi / Humbja e vitit | - | | | 718,384 | 718,384 |
| **Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse:** | | | (364,102) | 364,102 | - |
| **Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin:** | - | - | (364,102) | 1,082,486 | 718,384 |
| **Transaksionet me pronarët e njësisë ekonomike të njohura direkt në kapital:** | | | | | - |
| Emetimi i kapitalit të nënshkruar | 3,461,684 | | | | 3,461,684 |
| Dividendë të paguar | - | | | | - |
| **Totali i transaksioneve me pronarët e njësisë ekonomike** | 3,461,684 | - | - | - | 3,461,684 |
| **Pozicioni financiar i deklaruar më 31 dhjetor 2022** | ######### | - | (2,404,876) | 718,384 | 61,775,192 |
| **Pozicioni financiar i rideklaruar më 1 janar 2023** | ######### | - | (2,404,876) | 718,384 | 61,775,192 |
| **Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:** | | | | | - |
| Fitimi / Humbja e vitit | | | | 2,285,474 | 2,285,474 |
| **Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse:** | | | 718,384 | (718,384) | - |
| **Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin:** | - | - | 718,384 | 1,567,090 | 2,285,474 |
| **Transaksionet me pronarët e njësisë ekonomike të njohura direkt në kapital:** | | | | | |
| Emetimi i kapitalit të nënshkruar | | | | | |
| Dividendë të paguar | | | | | |
| **Totali i transaksioneve me pronarët e njësisë ekonomike** | - | - | - | - | - |
| **Pozicioni financiar i deklaruar më 31 dhjetor 2023** | ######### | - | (1,686,492) | 2,285,474 | 64,060,666 |

" ANTIGONE FINANCIAL ENTERPRISE„ sh.p.k.

Pasqyrat Financiare

Për vitin e mbyllur më **31 Dhjetor 2023**

(me raportin e audituesve të pavarur bashkëlidhur)

## Përmbajtja

Raporti i Audituesve të Pavarur ..........................................................................................................

**1.** Pasqyra e pozicionit financiar..........................................................................................................
**2.** Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse....................................
**3.** Pasqyra e ndryshimeve në kapital.....................................................................................................
**4.** Pasqyra e flukseve të parasë.............................................................................................................
**5.** Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare........................................................................ .......

ANTIGONE FINANCIAL ENTERPRISE M01329023A TIRANA-ALBANIA

[TO BE INSERTED THE AUDITORS' REPORT]

**Raport i Audituesit të Pavarur**

| | 31 Dhjetor 2023 | 31 Dhjetor 2022 |
|---|---|---|
| **AKTIVET** | | |
| **I. Aktivet Afatshkurtra** | | |
| Mjete monetare | 2,733,126 | 780,077 |
| Llogari te arketueshme | 29,222,794 | 1,901,486 |
| Të tjera të drejta afatshkurtra | 11,538,581 | 18,147,889 |
| Kapital I nenshkruar I papaguar | 40,000,000 | 40,000,000 |
| Inventarët | | |
| **Totali I aktiveve afatshkurtra** | **83,494,501** | **60,829,452** |
| **II. Aktivet afatgjata** | | |
| Te drejta arketueshme nga qiraja financiare | 195,625,455 | 280,445,109 |
| Aktive jo-materiale | | |
| Aktive tatimore të shtyra | | |
| **Totali I aktiveve afatgjata** | **195,625,455** | **280,445,109** |
| **TOTALI I AKTIVEVE** | **279,119,956** | **341,274,561** |
| **DETYRIMET** | | |
| **I. Detyrimet afatshkurtra** | | |
| Detyrime ndaj institucioneve te kredise | 52,317,101 | 57,119,458 |
| Aktetime ne avance | 16,686,832 | |
| Llogari te pagueshme | 11,936,886 | 15,583,856 |
| Të pagueshme ndaj punonjësve | 307,283 | 63,017 |
| Të pagueshme për detyrime tatimore | 811,584 | 250,470 |
| Të tjera detyrime afatshkurtra | 6,630,267 | 75,635 |
| **Totali I detyrimeve afatshkurtra** | **88,689,953** | **73,092,436** |
| **II. Detyrime afatgjata** | | |
| Detyrime te pagueshme per qera financiare AGJ | 117,369,337 | 197,406,933 |
| Borxh i varur | 9,000,000 | 9,000,000 |
| Të tjera detyrime afatgjata | | |
| Provizione | | |
| Borxh i varur | | |
| **Totali I detyrimeve afatgjata** | **126,369,337** | **206,406,933** |
| **Totali I Detyrimeve** | **215,059,290** | **279,499,369** |
| **III. Kapitali dhe Rezervat** | | |
| Kapitali I Nënshkruar | 63,461,684 | 63,461,684 |
| Rezerva të tjera | | |
| Fitimi I pashpërndarë | (1,686,492) | (2,404,876) |
| Fitim (humbja) e vitit | 2,285,474 | 718,384 |
| **Totali I Kapitalit** | **64,060,666** | **61,775,192** |
| **TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT** | **279,119,956** | **341,274,561** |

Pasqyra e pozicionit financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese që janë pjesë përbërëse e pasqyrave .

Këto pasqyra financiare janë miratuar nga Asambleja e Shoqërisë dhe janë nënshkruar në emër të tij nga:

**Z. Arlind Bala**
Administrator

ANTIGONE FINANCIAL ENTERPRISE M01329023A TIRANA - ALBANIA

***PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE***

| | Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2023 | Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2022 |
|---|---|---|
| **Te ardhurat nga aktiviteti kryesor** | 26,345,790 | 24,918,052 |
| **Te ardhura nga interesat** | 16,481,898 | 9,607,553 |
| **Te ardhurat nga rifaturim primi dhe komisionet disbursimit** | 9,863,892 | 15,310,499 |
| **Shpenzimet nga aktiviteti kryesor** | (16,802,647) | (13,683,047) |
| 1.Shpenzime nga rifaturim primi | (7,314,800) | (6,846,147) |
| 2. . Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme | (9,487,847) | (6,836,900) |
| **Shpenzime të personelit** | | |
| 1. Paga dhe shpërblime | (7,393,387) | (8,297,859) |
| 2. Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetsore | (979,450) | (981,608) |
| **Shpenzime per provigjione** | (2,243,860) | |
| **Shpenzime konsumi dhe amortizimi** | | |
| **Shpenzime të tjera shfrytëzimi** | (4,723,320) | (3,941,827) |
| **Fitimi (humbja) nga veprimtaritë e shfrytëzimit** | **(5,796,874)** | **(1,986,289)** |
| **Të ardhura të tjera** | | |
| 1. Të ardhura nga njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse | | |
| 2. Të ardhura nga investimet dhe huatë e tjera pjesë e aktiveve afatgjata | | |
| 3. Interesa të arkëtueshëm dhe të ardhura të tjera të ngjashme | | |
| **Zhvlerësimi i aktiveve financiare dhe investimeve financiare të mbajtura si aktive afatshkurtra** | | |
| **Shpenzime financiare** | | |
| 1. Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme | | |
| 2.Diferencat (+/-) nga perkthimi i monedhes ne veprimtari te huaj | 8,988,778 | 2,704,673 |
| **Fitimi (humbja) para tatimit** | **3,191,904** | **718,384** |
| **Shpenzimi i tatimit mbi fitimin** | | |
| 1. Shpenzimi i tatim fitimit të periudhës | | |
| 2. Shpenzimi i tatim fitimit të shtyrë | (906,430) | |
| 3. Pjesa e tatim fitimit të pjesëmarrjeve | | |
| **Fitimi (humbja) neto e vitit** | **2,285,474** | **718,384** |
| Te ardhura te tjera gjitheperfshirese per vitin | | |
| Diferencat (+/-) nga perkthimi i monedhes ne veprimtari te huaj | | |
| Diferencat (+/-) nga rivlersimi i aktiveve afatgjata materiale | | |
| Diferencat (+/-) nga rivlersimi i aktiveve financiare te mbartura per shitje | | |
| Pjesa e te ardhurave gjitheperfshirese nga pjesemarrjet | | |
| Totali i te ardhurave te tjera gjitheperfshirese per vitin | | |
| **Totali i te Ardhurave Gjitheperfshirese per vitin** | **2,285,474** | **718,384** |

Pasqyra e fitimit dhe humbjes duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese që janë pjesë përbërëse e pasqyrave .

Këto pasqyra financiare janë miratuar nga Asambleja e Shoqërisë dhe janë nënshkruar në emër të tij nga:
Z. Arlind Bala
Administrator

## *PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE*

| *(metoda indirekte)* | Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2023 | Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2022 |
|---|---|---|
| **I. Fluksi I Mjeteve Monetare nga / perdorur ne aktivitetin e shfrytezimit** | | |
| Fitim/ Humbja e periudhes | 2,285,474 | 718,384 |
| Ndryshime ne aktivet dhe detyrimet e shfrytezimit: | | |
| *Renie / (rritje) ne te drejtat e arketueshme dhe te tjera* | (20,712,000) | (16,256,382) |
| *Renie / (rritje) ne inventare* | - | - |
| *Rritje / (renie) ne detyrimet e pagueshme* | 20,155,608 | 6,569,838 |
| *Rritje / (renie) ne detyrimet per punonjesit* | 244,266 | (365,387) |
| *Rritje / (renie) ne detyrimet e tjera* | | |
| **Mjete monetare nga / perdorur ne aktivitetin e shfrytezimit** | **1,973,348** | **(9,333,547)** |
| **II. Fluksi I Mjeteve Monetare nga / perdorur ne aktivitetin e investimit** | | |
| *a. Renie ne te drejtat e arketueshme nga qeraja financiare* | 84,819,654 | (149,912,506) |
| *b. Para te arketuara nga shitja e filialeve (shuma neto)* | | |
| *c. Pagesa per blerjen e aktiveve afatgjata materiale* | | |
| *d. Arketime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale* | | |
| *e. Pagesa per blerjen e investimeve te tjera* | | |
| *f. Arketime nga shitja e investimeve te tjera* | | |
| *g. Dividende te arketuar* | | |
| **Mjete monetare nga / perdorur ne aktivitetin e investimit** | **84,819,654** | **(149,912,506)** |
| **III. Fluksi I Mjeteve Monetare nga / perdorur ne aktivitetin e financimit** | | |
| *a. Arketime nga emetimi I kapitalit* | - | 3,461,684 |
| *b. Arketime nga borxh I varur* | | 9,000,000 |
| *c. Pagese e detyrimeve te qirase financiare* | (79,538,527) | 87,224,989 |
| *d. Pagesa e kostove te transaksionit qe lidhen me kredite dhe huate* | - | - |
| *e. Interes I paguar* | (9,487,847) | (6,836,900) |
| *f. Pagesa e aksioneve te perdorura si kolateral* | - | |
| *g. Pagesa e huave* | (4,802,357) | 57,119,458 |
| *h. Pagese e detyrimeve te qirase financiare* | | |
| *i. interes I paguar* | | |
| *j. Dividende te paguar* | | |
| **Mjete monetare nga / perdorur ne aktivitetin e financimit** | **(93,828,731)** | **149,969,231** |
| **IV. Rritja/(pakesimi) neto i mjeteve monetare** | **(7,035,729)** | **(9,276,822)** |
| **V. Mjetet monetare ne fillim te periudhes** | **780,077** | **7,352,226** |
| **Efekti i luhatjeve te kurseve te kembimit te mjeteve monetare** | **8,988,778** | **2,704,673** |
| **VI. Mjetet monetare ne fund te periudhes** | **2,733,126** | **780,077** |

Pasqyra e flukseve te parase duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese që janë pjesë përbërëse e pasqyrave .

Këto pasqyra financiare janë miratuar nga Asambleja e Shoqërisë dhe janë nënshkruar në emër të tij nga:

Z. Arlind Bala
Administrator

FINANCIAL ENTERPRISE ALBANIA M01329023A

***PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITALIN NETO***

| | Kapitali i nënshkruar | Rezerva të tjera | Fitimet e Pashpërndara | Fitim / Humbja e vitit | Totali |
|---|---|---|---|---|---|
| **Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2021** | 60,000,000 | - | (2,040,774) | (364,102) | 57,595,124 |
| Efekti i ndryshimeve në politikat kontabël | | | | | - |
| **Pozicioni financiar i rideklaruar më 1 janar 2022** | 60,000,000 | - | (2,040,774) | (364,102) | 57,595,124 |
| **Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:** | | | | | - |
| Fitimi / Humbja e vitit | - | | | 718,384 | 718,384 |
| **Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse:** | | | (364,102) | 364,102 | - |
| **Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin:** | - | - | (364,102) | 1,082,486 | 718,384 |
| **Transaksionet me pronarët e njësisë ekonomike të njohura direkt në kapital:** | | | | | - |
| Emetimi i kapitalit të nënshkruar | 3,461,684 | | | | 3,461,684 |
| Dividendë të paguar | - | | | | - |
| **Totali i transaksioneve me pronarët e njësisë ekonomike** | 3,461,684 | - | - | - | 3,461,684 |
| **Pozicioni financiar i deklaruar më 31 dhjetor 2022** | 63,461,684 | - | (2,404,876) | 718,384 | 61,775,192 |
| **Pozicioni financiar i rideklaruar më 1 janar 2023** | 63,461,684 | - | (2,404,876) | 718,384 | 61,775,192 |
| **Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:** | | | | | - |
| Fitimi / Humbja e vitit | | | | 2,285,474 | 2,285,474 |
| **Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse:** | | | 718,384 | (718,384) | - |
| **Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin:** | - | - | 718,384 | 1,567,090 | 2,285,474 |
| **Transaksionet me pronarët e njësisë ekonomike të njohura direkt në kapital:** | | | | | |
| Emetimi i kapitalit të nënshkruar | | | | | |
| Dividendë të paguar | | | | | |
| **Totali i transaksioneve me pronarët e njësisë ekonomike** | - | - | - | - | - |
| **Pozicioni financiar i deklaruar më 31 dhjetor 2023** | 63,461,684 | - | (1,686,492) | 2,285,474 | 64,060,666 |

Pasqyra e ndryshimeve ne kapital duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese që janë pjesë përbërëse e pasqyrave .

Këto pasqyra financiare janë miratuar nga Asambleja e Shoqërisë dhe janë nënshkruar në emër të tij nga:

Z. Arlind Bala
Administrator

# Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare

**Informacion i Përgjithshëm**

**" ANTIGONE FINANCIAL ENTERPRISE " sh**.p.k. ("Shoqeria") është themeluar në 28 Janar 2020 si një shoqeri me përgjegjësi të kufizuar. Aktiviteti i Shoqërisë rregullohet në bazë të Ligjit Nr.9396, datë 12.05.2005 "Për Qirate Financiare". Shoqeria është e regjistruar prane Qendrës Kombetare të Biznesit me Numër Unik të Identifikimit (NIPT) **M01329023A** dhe është licensuar nga Banka e Shqipërisë si një institucion financiar jo-bankar, me licencë Nr. 48, datë 12.3.2021.

***Aktiviteti kryesor.*** Veprimtaria e qirase financiare sic parashikohet nga dhe ne perputhje me dispozitat e ligjit nr. 9396, date 15.05.2005, "'Per qirane financiare", ndryshimet e tij, dhe sic mund te ndryshohet ne te ardhmen. Shoqeria do te jape dhe marre me qira financiare sende te luajtshme e te paluajteshme si dhe ofrimin e sherbimeve ndihmese per mirembajtjen e tyre, te dhena me qira sipas kontratave perkatese. Po ashtu, shoqeria mund te permbushe dhe cdo lloj tjeter aktiviteti dhe veprimi te nevojshem apo te dobishem prane te treteve, institiucioneve private ose shteterore per arritjen e qellimeve te mesiperme dhe qe nuk kufizohen nga legjislacioni shqiptar ne fuqi.

***Adresa e regjistruar dhe vendi i biznesit.*** TIRANE Rruga Mine Peza, Pallati 1, Shk.1, Ap.4, Shqiperi

***Monedha funksionale dhe prezantuese.*** Pasqyrat financiare paraqiten në monedhen shqiptare Lekë ("LEK"), e cila është gjithashtu monedha funksionale e shoqerisë, monedhë e mjedisit kryesor ekonomik në Republikën e Shqipërisë.

## 2. Përmbledhje e Politikave Kryesore të Kontabilitetit

### 2.1 Bazat e pergatitjes

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF") sipas udhezimit te Bordit te Standarteve Kontabel Nderkombetare nën konventën e kostos historike. Politikat kryesore të kontabilitetit të përdorura në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare janë përcaktuar më poshtë. Këto politika janë zbatuar në mënyrë të vazhdueshme për të gjitha periudhat e paraqitura, përveç nëse përcaktohet ndryshe.

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon që drejtimi të bëjë vlerësime dhe supozime. Menaxhimi u mbështet në gjykimin e tyre kur zbatonte politikat e kontabilitetit të Shoqerisë.

### Parimi i vijueshmerise

Drejtimi i Shoqerise ka bërë një vlerësim të aftësisë së saj për vijueshmeri dhe është i kënaqur që ka burimet për të qendruar ne biznes ne të ardhmen e parashikueshme. Për më tepër, drejtimi nuk është i vetëdijshëm për ndonjë pasiguri materiale që mund të hedhë dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e Shoqerise për vijueshmeri. Per rrjedhoje, pasqyrat financiare vazhdojnë të përgatiten mbi bazën e vijueshmerise.

### 2.2 Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon përdorimin e disa vlerësimeve kontabël kritike. Kerkohet gjithashtu që drejtimi të ushtrojë gjykimin e tij në procesin e zbatimit të politikave kontabël të Shoqerisë. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime. Vlerësimet dhe supozimet thelbesore rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në çdo periudhë të ardhshme që preket. Drejtimi beson se supozimet bazë janë të përshtatshme dhe se pasqyrat financiare për këtë arsye paraqesin pozicionin dhe rezultatet financiare në mënyrë të drejtë.

ANTIGONE FINANCIAL ENTERPRISE M01329023A TIRANA-ALBANIA

## 2. Përmbledhje e Politikave Kryesore të Kontabilitetit (vazhdim)

### 2.3 Transaksionet dhe balancat në valutë të huaj

Aktivet monetare dhe detyrimet të regjistruara në monedhë të huaj në datën e raportimit jane këmbyer në monedhën funksionale të Shoqerise me kursin e këmbimit të Bankës së Shqipërisë (BSH) në datën e raportimit.

Fitimi ose humbja që vjen nga këmbimet valutore të transaksioneve në monedhë të huaj dhe nga këmbimet e aktiveve dhe detyrimeve monetare në monedhë të huaj si dhe përkthimet e tyre ne monedhë funksionale bazuar në kursin e BSH në fund të vitit, njihen në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse. Fitimet dhe humbjet nga kurset e këmbimit të lidhura me huatë, mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre njihen në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse brenda "Kostot financiare". Të gjitha fitimet dhe humbjet nga kurset e këmbimit të tjera janë prezantuar në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse në "Fitime / (humbje) të tjera, neto".

Përkthimet e kryera në fund të vitit nuk aplikohen për zërat jo-monetar të matura me kosto historike. Zërat jo-monetar të matur në monedhë të huaj me vlerën e drejtë, përkthehen duke përdorur kursin e datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Efektet e ndryshimeve të kursit të këmbimit regjistrohen si pjesë e fitimit apo humbjes së vlerës së drejtë.

### 2.4 Të ardhurat nga interesi

Të ardhurat nga interesi regjistrohen për të gjitha aktivet financiare mbi bazën akruale duke përdorur metodën e interesit efektiv. Kjo metodë shtyn, si pjesë e të ardhurave nga interesi, të gjitha tarifat e marra midis palëve në kontratë që janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit, të gjitha primet ose zbritjet e tjera, nëse ka.

Tarifat integrale të normës efektive të interesit përfshijnë tarifat e origjinës të marra ose të paguara nga shoqerisë në lidhje me krijimin ose blerjen e një aktivi financiar. Të ardhurat nga interesi llogariten duke aplikuar normën efektive të interesit në vlerën kontabël bruto të aktiveve financiare.

**Norma efektive e interest**

Norma efektive e interesit është norma e brendshme e kthimit të pagesave nga një aktiv financiar ose detyrimi financiar, prsh zbritja e flukseve të parave të pritshme në të ardhmen me normën efektive të interesit jep vlerën kontabël bruto të një aktivi financiar ose koston e amortizuar të një detyrimi financiar. Në njohjen fillestare të një aktivi financiar ose detyrimi financiar, kjo është vlera e drejtë plus kostot e transaksionit.

### 2.5 Te ardhura te tjera

Te ardhura te tjera perfshijne komisionet e marra nga shoqeritë e sigurimeve për policat e sigurimeve të shitura në lidhje me mjetet e dhëna me qira financiare perfshihen në të ardhura nga tarifa dhe komisione dhe njihen kur është dhënë shërbimi, kur policat janë aprovuar nga shoqerite e sigurimeve. Shoqeria eshte një agjent për këtë shërbim dhe të ardhurat njihen në një moment të caktuar.

Në përputhje me këtë, të ardhurat e tjera njihen si më poshtë:

- Të ardhura të tjera të fituara gjatë ekzekutimit të një transaksioni

Të ardhura të tjera përfshijnë të ardhurat nga brokerimi i sigurimeve dhe tarifa nga pagesat e vonuara dhe kontratat e qirave të përfunduara perpara afatit. Këto të ardhura që janë të lidhura me një performancë të caktuar njihen pasi kryhen shërbimet e lidhura me to.

### 2.6 Shpenzimet e interesit

Shpenzime interesi përbëhet nga interesi mbi huatë. Diferenca ndërmjet të ardhurave (kostoja neto e transaksionit) dhe vlerës së riblerjes do të njihet në fitim ose humbjen e periudhës përgjatë kohëzgjatjes së huasë duke përdorur metodën e interesit efektiv.

### 2.7 Përfitimet e punonjësve

Shoqëria paguan vetëm kontribute të detyrueshme të sigurimeve shoqërore të cilat sigurojnë të ardhura pensioni për punonjësit pas daljes në pension. Qeveria e Shqipërisë eshte përgjegjëse për përcaktimin e kufirit ligjor minimal për pensionet në kuadër të juridiksionit përkatës sipas një plani të kontributeve të përcaktuar. Kontributet e Shoqërisë në planin e pensionit i ngarkohen pasqyrës së fitim humbjeve kur ato ndodhin. Shpenzimet e personelit, duke përfshirë pagat dhe bonuset, njihen mbi bazën e të drejtave të konstatutara kur kanë ndodhur.

### 2.8 Aktivet afatgjata materiale

Nje aktiv afatgjate material matet me koston e tij. Ato paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi, nëse ka. Kostoja përfshin shpenzimet që janë drejtpërdrejt të atribueshme ndaj blerjes së aktivit. Kur pjese te nje aktivi afatgjate material kane jete te dobishme te ndryshme, ato kontabilizohen si pjese te vecanta (pjese kryesore) te aktivit.

Fitimi ose humbja nga nxjerrja jashte perdorimi e nje aktivi afatgjate material percaktohet duke krahasuar te ardhurat nga shitja me vleren neto kontabel te aktivit dhe njihet per neto si te ardhura/shpenzime te tjera operative ne fitim ose humbje. Kostot e mirembajtjes se vazhdueshme te aktiveve afatgjata materiale njihen ne fitim ose humbje brenda 12 muajve. Kostoja e zevendesimit te nje pjese te aktivit afatgjate material njihet ne vleren e mbartur te aktivit nese prej saj Shoqeria mund te perfitoje ekonomikisht.

Në fund të çdo periudhe raportuese, drejtimi vlerëson nëse ka ndonjë tregues per dëmtimin e aktiveve afatgjata materiale. Nëse ekziston ndonjë tregues i tillë, drejtimi vlerëson shumën e rikuperueshme, e cila përcaktohet si më e larta midis vlerës së drejtë të një aktivi minus kostot e nxjerrjes jashtë përdorimit dhe vlerës së tij në përdorim. Vlera kontabël reduktohet në shumën e rikuperueshme dhe humbja e pritshme njihet në fitim ose humbje për vitin.

Një humbje e pritshme e njohur për një aktiv në vitet e mëparshme rimerret kur është e përshtatshme nëse ka pasur një ndryshim në vlerësimet e përdorura për të përcaktuar vlerën në përdorim të aktivit ose vlerën e drejtë minus kostot e nxjerrjes jashtë përdorimit.

Amortizimi i aktiveve llogaritet per cdo aktiv mbi bazën e jetës së tyre te dobishme. Normat vjetore te amortizimit vjetor janë si më poshtë:

| | |
|---|---|
| Makina | 20 % metoda e vlerës së mbetur |
| Paisje elektronike | 25 % metoda e vlerës së mbetur |
| Paisje dhe mobilje për zyrë | 20 % metoda e vlerës së mbetur |

Vlera e mbetur e një aktivi është shuma e vlerësuar që Shoqëria do të merrte nga nxjerrja jashtë përdorimit të aktivit, minus kostot e vlerësuara të nxjerrjes jashtë përdorimit, nëse aktivi ishte tashmë i vjetër dhe në gjendjen e pritur në fund të jetës së tij të dobishme. Vlera e mbetur dhe jeta e dobishme e aktiveve rivlerësohen dhe rregullohen në fund te cdo periudhe raportuese. Humbjet dhe fitimet nga nxjerrja jashtë përdorimit e aktiveve afatgjata materiale llogariten duke krahasuar të ardhurat nga nxjerrja jashtë përdorimit ndaj vlerës se mbetur të tyre, dhe diferenca njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kur Shoqëria, gjatë aktiviteteve të saj të zakonshme, u shet të tjerëve automjete që mbahen me qira, aktive te tilla transferohen në inventarë në vlerën e tyre kontabël kur ndalon qiradhenia per to. Të ardhurat nga shitja e këtyre aktiveve njihen si të ardhura të paraqitura nën "Të ardhura të tjera operative" në përputhje me SNRF 15 "Të Ardhurat nga Kontratat me Klientët".

## 2.9 Aktivet afatgjata jo-materiale

Aktivet afatgjata jo-materiale përfshijnë liçensat kompjuterike. Liçensat kompjuterike të programeve janë kapitalizuar në bazë të kostos së ndodhur për të siguruar dhe për të sjellë në përdorim programin e caktuar. Këto kosto amortizohen në mënyrë lineare në bazë të jetës së dobishme të liçencës, e cila vlerësohet me një jetëgjatësi prej shtatë vitesh.

| | |
|---|---|
| Software | 15% metoda lineare |

## 2.10 Zhvlerësimi i aktiveve jo-financiare

Aktivet që janë objekt i amortizimit dhe zhvlerësimit rishikohen për zhvlerësim në çdo datë raportuese sa herë që ndeshemi me ndryshime të rrethanave të cilat mund të na cojnë drejt përfundimit që vlera e mbetur mund të mos jetë më e rikuperueshme. Humbja nga zhvlerësimi njihet si shuma me të cilën vlera e mbetur e aktivit tejkalon vlerën e tij të rikuperueshme. Vlera e rikuperueshme është vlera më e lartë midis vlerës në përdorim dhe diferencës së vlerës së drejtë të aktivit me koston e shitjes. Per qellimin e percaktimit zhvlerësimi, aktivet grupohen sipas likuiditetit rënës, ku flukset monetare paraqiten veçmas (njesi gjeneruese te mjeteve monetare).

## 2.11 Inventarët

Inventarët maten në nivelin më të ulët të kostos dhe vlerës neto të realizueshme. Kostoja e inventarëve bazohet në metodën specifike të identifikimit dhe përfshin të gjitha kostot e blerjes, kostot e konvertimit dhe kostot e tjera të bëra për sjelljen e inventarëve në vendndodhjen dhe gjendjen e tyre aktuale. Vlera e realizueshme neto është çmimi i vlerësuar i shitjes në rrjedhën e zakonshme të biznesit, minus kostot e vlerësuara të përfundimit dhe shpenzimet e shitjes. Shoqeria vlerëson në fund të çdo periudhe raportimi nëse vlera kontabël e inventarëve të saj është e rikuperueshme për shkak të dëmtimit, vjetërsimit dhe / ose rënies së çmimeve. Nëse një artikull ose grup artikujsh në inventar është dëmtuar, Shoqeria njeh një humbje nga zhvlerësimi.

## 2.12 Instrumentet financiare

- **Instrumentet financiare - Njohja fillestare**

Instrumentet financiare fillimisht regjistrohen në vlerën e drejtë të rregulluar për kostot e transaksionit. Vlera e drejtë në njohjen fillestare dëshmohet më së miri nga çmimi i transaksionit. Një fitim ose humbje nga njohja fillestare regjistrohet vetëm nëse ekziston një ndryshim midis vlerës së drejtë dhe çmimit të transaksionit i cili mund të dëshmohet nga transaksione të tjera të vëzhguara të tregut aktual në të njëjtin instrument ose nga një teknikë vlerësimi, inputet e të cilit përfshijnë vetëm të dhëna nga tregjet e vëzhguara. Pas njohjes fillestare, një humbje e pritshme e kredise ( HPK ) njihet për aktivet financiare të matura me koston e amortizuar ( KA ) duke rezultuar në një humbje kontabel të menjëhershme.

ANTIGONE FINANCIAL ENTERPRISE M01329023A TIRANA

Vlera e drejtë është çmimi që do të merrej për shitjen e një aseti apo paguhej për të transferuar një detyrim në një transaksion të zakonshëm midis pjesëmarrësve tregtarë në datën e matjes. Prova më e mirë e vlerës së drejtë eshte çmimi në një treg aktiv. Tregu aktiv është ai treg në të cilin transaksionet për një aset apo detyrim ndodhin në frekuenca dhe vëllime të mjaftueshme për të siguruar informacione të vazhdueshme mbi çmimet.

Vlera e drejtë e instrumenteve financiarë të tregtuar në një treg aktiv matet si produkt i çmimit të kuotuar për asetin apo detyrimin individual dhe sasisë së instrumenteve të mbajtur nga Shoqëria. Ky rast vlen gjithashtu dhe nëse vëllimi normal ditor i tregtimin të nje tregu nuk është i mjaftueshëm për të absorbuar sasinë e mbajtur, dhe bërja e porosive me qëllim shitjen e stokut me anë të një transaksioni të vetëm mund të prekë çmimin e kuotuar.

*Teknikat e vlerësimit* siç janë modelet e skontimit të flukseve të mjeteve monetare ose modele të bazuara në transaksionet *on arm's length* të kryera së fundmi ose ato të shqyrtimit të të dhënave financiare të Shoqërisë ku do të investohet përdoren për të matur vlerën e drejtë të instrumenteve të caktuara financiare për të cilat informacioni i jashtëm mbi çmimin e tregut nuk është i disponueshëm. Matjet e vlerës së drejtë analizohen sipas nivelit në hierarkinë e vlerës së drejtë si vijon: (i) niveli i parë janë matjet me çmime të kuotuara (të parregulluara) në tregjet aktive për aktivet ose detyrimet identike,
(ii) matjet e nivelit të dy janë teknikat e vlerësimit me të gjitha inputet materiale (iii) matjet e nivelit të tretë janë vlerësime që nuk bazohen vetëm në të dhënat e vëzhgueshme të tregut (domethënë matja kërkon inpute të rëndësishme të pavëzhgueshëm).

- **Klasifikimi i instrumenteve financiare**

Shoqeria i klasifikon të gjitha aktivet e saj financiare bazuar në modelin e biznesit për menaxhimin e aktiveve dhe kushtet kontraktuale të aktivit, të matura me koston e amortizuar. Nje aktiv financiar matet me koston e amortizuar nese ploteson te dyja kushtet e meposhtme dhe nuk eshte caktuar si Vlera e drejte permes fitimit ose humbjes (VDNFH).

- Aktivi mbahet brenda një modeli biznesi, qëllimi i të cilit është të mbajë aktive qe gjenerojne flukse monetare kontraktuale; dhe
- Kushtet kontraktuale të aktiveve financiare japin rritje në datat e specifikuara të flukseve të parave që janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit mbi shumën e principalit të papaguar.

*Kostoja e amortizuar* ("KA") është shuma në të cilën instrumenti financiar është njohur në njohjen fillestare minus pagesën e çdo principali, plus interesin e përllogaritur, dhe për aktivet financiare minus çdo kompensim për humbjet e pritshme të kredisë ("HPK"). Interesi i përllogaritur përfshin amortizimin e kostove të transaksionit të shtyra në njohjen fillestare duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Të ardhurat e akumuluara të interesit dhe shpenzimet e akumuluara interesit të përllogaritur, përfshirë tarifat e shtyra në fillim, nuk paraqiten veçmas dhe përfshihen në vlerat bartëse të zërave në pasqyrën e pozicionit financiar.

*Metoda e interesit efektiv* është një metodë e shperndarjes së të ardhurave nga interesi ose shpenzimeve të interesit gjatë periudhës përkatëse, në mënyrë që të arrihet një normë periodike konstante e interesit (norma efektive e interesit) në vlerën kontabël. Norma efektive e interesit është norma që zbret flukset dalëse të ardhshme të parasë ose faturat (duke përjashtuar humbjet e ardhshme të kredisë) sipas jetës së pritshme të instrumentit financiar ose një periudhe më të shkurtër, nëse është e përshtatshme, në vlerën kontabël neto të instrumentit financiar.

Norma efektive e interesit zbret fluksin e mjeteve monetare të instrumenteve me interes të ndryshueshëm deri në datën e ardhshme të rivlerësimit të interesit, ose tregues të tjerë që nuk vendosen në normat e tregut. Llogaritja e vlerës aktuale përfshin të gjitha pagesat e paguara ose të marra midis palëve në kontratë që janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit.

- **Aktivet financiare - klasifikimi dhe matja pasuese - kategoritë e matjes**

Shoqëria klasifikon aktivet financiare si kategori të matjes së KA-s. Klasifikimi dhe matja pasuese e aktiveve financiare të borxhit varet nga: (i) modeli i biznesit të Shoqërisë për administrimin e portofolit të aktiveve të lidhura dhe (ii) karakteristikat e fluksit të parave të aktivit.

- **Aktivet financiare - klasifikimi dhe matja *e mepasme* - modeli i biznesit**

Modeli i biznesit reflekton mënyrën sesi Shoqëria menaxhon aktivet për të gjeneruar fluks monetar – nëse objektivi i Shoqërisë është: (i) vetëm mbledhja e flukseve të mjeteve monetare kontraktuale ("mbajtja per mbledhje e flukseve monetare") ose (ii) mbledhja e flukseve të mjeteve monetare kontraktuale dhe të flukseve monetare që gjenerohen nga shitja e aktiveve ("mbajtja per mbledhje e flukseve monetare dhe shitje") ose, nëse objektivi (i) dhe (ii) është jo i aplikueshëm, aktivet financiare klasifikohen si pjesë e modelit te biznesit "të tjera" dhe maten në VDNFH.

Modeli i biznesit përcaktohet për aktivet financiare individuale (në nivel portofoli) bazuar në të gjithe evidencen përkatëse për aktivitetet që Shoqëria ndërmerr për të arritur objektivin e caktuar për aktivin individual në dispozicion në datën e vlerësimit.

Faktorët që konsiderohen nga Shoqëria në përcaktimin e modelit të biznesit përfshijnë: qëllimin dhe kompozimin e portofolit, përvojën e kaluar në mënyrën se si janë arkëtuar flukset e mjeteve monetare për aktivet përkatëse, si vlerësohen dhe menaxhohen rreziqet, si vlerësohet performanca e aktiveve dhe si kompensohen drejtuesit. Modeli i biznesit të shoqerisë është "Mbajtja per te mbledhur flukset monetare kontraktuale".

- **Aktivet financiare - klasifikimi dhe matja e mepasme – Karakteristikat e fluksit të mjeteve monetare**

Kur modeli i biznesit ka si objektiv mbajtjen e aktiveve per mbledhjen e flukseve monetare kontraktuale, Shoqëria vlerëson nëse flukset e mjeteve monetare përfaqësojnë vetëm pagesat e principalit dhe interesit ("VPPI"). Gjatë këtij vlerësimi, Shoqëria konsideron nëse flukset e mjeteve monetare kontraktuale janë në përputhje me një marrëveshje bazë të huadhënies, pra interesi përfshin vetëm shumën për riskun e kredisë, vlerën kohore të parasë, risqet e tjera bazë të huadhënies dhe marzhin e fitimit. Vlerësimi i shoqerisë arrin në përfundimin se fluksi i parave të instrumenteve të tij financiar paraqet vetëm pagesa të principalit dhe interesi.

**Aktivet financiare - riklasifikimi**

Instrumentet financiare riklasifikohen vetëm kur ndryshon modeli i biznesit për administrimin e portofolit në tërësi. Riklasifikimi ka një efekt të ardhshëm dhe bëhet nga fillimi i periudhës së parë të raportimit që pason pas ndryshimit në modelin e biznesit. Shoqeria nuk e ndryshon modelin e saj të biznesit gjatë periudhës aktuale dhe krahasuese dhe nuk bën ndonjë riklasifikim.

**Zhvlerësimi i aktiveve financiare - Humbja nga zhvleresimi i qerase financiare HPK**

Humbja nga zhvleresimi i qirase financiare përcaktohet duke përdorur metodën e thjeshtuar të SNRF 9, humbje e plote, duke nënkuptuar fazën 2 për kontratat e qirasë, për sa kohë që ato nuk janë te paracaktuar.

Per matjen e humbjes se pritshme, te arketueshmet nga qiraja financiare janë grupuar bazuar në karakteristikat e përbashkëta të rrezikut të kredisë dhe ditët e kaluara. Normat e pritshme te humbjes jane bazuar në profilet e pagesave të shitjeve gjatë një periudhe kohe dhe humbjet përkatëse historike të kredisë brenda kesaj periudhe.

Normat historike te humbjeve jane rregulluar per te pasqyruar informacionin aktual dhe te ardhshem te faktoreve makroekonomik qe ndikojne në aftësinë e klientëve për të shlyer detyrimet.

**Aktivet financiare – fshirje**

Aktivet financiare fshihen tërësisht ose pjesërisht, kur Shoqëria ka kryer cdo përpjekje për mbledhjen e detyrimit dhe ka arritur në përfundimin se nuk ka pritshmëri të arsyeshme për rikuperim te detyrimit. Fshirja përfaqëson një rast të çregjistrimit.

Shoqëria mund të fshije aktivet financiare që janë subjekt i zbatimit me forcë të marrëveshjes kur Shoqëria kërkon të rikuperojë shumat që janë të arkëtueshme sipas termave kontraktualë, megjithatë, nuk ka pritshmëri të arsyeshme për rikthimin e tyre.

**Aktivet financiare - çregjistrim**

Shoqëria çregjistron aktivet financiare kur (a) aktivet shlyhen ose të drejtat për flukset e mjeteve monetare nga aktivet përfundojnë ose (b) Shoqeria ka transferuar të drejtat për arkëtimin e flukseve monetare nga aktivet financiare ose ka hyrë në një marrëveshje likuidimi ndërkohë që (i) gjithashtu transferon thelbësisht të gjitha risqet dhe të drejtat e pronësisë së aktiveve ose (ii) as i transferon as i mban thelbësisht të gjitha risqet dhe të drejtat e pronësisë por duke mos mbajtur kontrollin mbi to. Kontrolli mbahet nëse pala tjetër nuk zotëron aftësinë praktike për të shitur aktivin si një i tërë tek një palë e tretë e palidhur, pa qenë nevoja të diktojë kufizime shtesë në shitje.

**2.13 Detyrimet financiare - kategoritë e matjes**

Detyrimet financiare klasifikohen si të matura me kontratat e kostos së amortizuar.

**Detyrimet financiare - çregjistrim**

Detyrimet financiare çregjistrohen kur ato likuidohen (d.m.th. kur detyrimi i specifikuar në kontratë paguhet, anulohet ose skadon). Modifikimet e detyrimeve që nuk rezultojnë në shlyerje llogariten si një ndryshim në vlerësim duke përdorur metodën e kapjes kumulative, me çfarëdo fitim ose humbje të njohur në pasqyrën e performancës, për sa kohë që thelbi ekonomik i diferencës në mbartjen e vlerave nuk i atribuohet një transaksioni kapital me pronarët.

**2.14 Netimi i instrumenteve financiare**

Aktivet dhe detyrimet financiare netohen dhe shuma neto raportohet në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm kur ekziston një e drejtë e detyrueshme ligjore për netimin e shumave të njohura dhe ekziston qëllimi për shlyerje në baza neto ose realizimin e aktivit dhe shlyerjen e detyrimit në të njëjtën kohë. Kjo e drejtë netimi (a) nuk duhet të jetë e kushtëzuar nga një ngjarje e ardhshme dhe (b) duhet të jetë ligjërisht e zbatueshme në të gjitha rrethanat e mëposhtme: (i) në rrjedhën normale të biznesit, (ii) në rast mospagese dhe (iii) në rast të paaftësisë paguese ose falimentimit.

**2.15 Llogaritë e qirave financiare të arkëtueshme**

Kur Shoqëria ka rolin e qiradhënësit në një marrëdhënie qiraje, në të cilën transferon të gjitha rreziqet dhe përfitimet tek qiramarrësi, aktivet e dhëna me qira pasqyrohen si qira financiare të arkëtueshme dhe me një vlerë të barabartë me investimin neto te qirase.

Në datën e fillimit, matja e investimit neto në qira përfshin këto pagesa të qirasë:

- pagesa fikse (përfshirë pagesa fikse në substancë), minus çdo stimulim i qirasë që paguhet,
- shumat që pritet të pranohen nga shoqeria nën garanci të vlerës së mbetjes, dhe
- pagesa e gjobave për ndërprerjen e qirasë, nëse afati i qirasë pasqyron qiramarrësin që ushtron atë opsion.

**2.16 Llogaritë e qirave financiare të arkëtueshme (vazhdim)**

Qiratë financiare të arkëtueshme njihen në fillim (kur kontrata e qirasë fillon) duke perdorur nje norme zbritje ne matjen neto te investimit te qirase.

Diferenca ndërmjet të arkëtueshmeve bruto dhe vlerës aktuale përfaqëson të ardhurat financiare të papërfituara. Kjo e ardhur njihet përgjatë kohëzgjatjes së qirasë financiare duke përdorur metodën e investimit neto (përpara tatimit), e cila paraqet një normë kthimi periodike. Kostot shtesë që i atribuohen në mënyrë direkte marrëveshjes së qirasë financiare përfshihen në matjen fillestare të qirasë financiare të arkëtueshme dhe zvogëlojnë shumën e të ardhurave të njohura gjatë kohëzgjatjes së qirasë financiare, përveç rasteve kur Shoqëria sillet si prodhues ose qiradhënës, në çdo rast këto kosto janë njohur si pjesë e fitimit të shitjes në mënyrë të ngjashme me shitjet e drejtpërdrejta. Të ardhurat financiare nga qiraja përfshihen në llogarinë e të ardhurave nga interesi në humbjen apo fitimin e vitit.

**2.17 Te arketueshme nga qiraja operacionale**

Kur Shoqëria është qiradhënëse në një qira që nuk i transferon te qiramarrësi thelbesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet që lidhen me pronësinë, qiraja klasifikohet si qira operacionale. Shoqeria ka detyrimin dhe përballon koston e mirëmbajtjes dhe shpenzimet e tjera që lidhen me aktivet e dhëna me qira. Qiradhënësi nuk ka urdhër blerje. Automjetet me qira operative amortizohen në bazë të jetëgjatësisë së kontratës dhe duke marrë parasysh vlerën e mbetur në fund të kontratës së qirasë. Amortizimi nuk pushon kur aktivi bëhet i papunë ose është tërhequr nga përdorimi aktiv, megjithatë, tarifa e amortizimit mund të jetë zero kur nuk ka prodhim ose marrëveshjet e qirasë operacionale janë ndërprerë. Një provizion për rrezikun e vlerës së mbetur vlerësohet nga Shoqeria.

**2.18 Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre**

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre përfshijnë llogarite rrjedhese me bankat, të cilat janë subjekt i një rreziku të parëndësishëm të ndryshimeve në vlerën e tyre të drejtë dhe përdoren nga shoqeria në administrimin e angazhimeve të saj afatshkurtra. Paratë e gatshme dhe ekuivalentët e tyre mbahen në AC sepse: (i) ato mbahen për mbledhjen e flukseve monetare kontraktuale dhe ato flukse monetare përfaqësojnë SPPI, dhe (ii) ato nuk janë caktuar në FVTPL.

**2.19 Tatimi mbi të ardhurat**

Tatimi mbi të ardhurat është parashikuar në pasqyrat financiare në përputhje me legjislacionin ne fuqi në fund të periudhës së raportimit. Tatimit mbi të ardhurat përfshin tatimin aktual dhe tatimin e shtyrë, kur është material, dhe njihet në fitim ose humbje për vitin, përveç nëse njihet në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse ose drejtpërdrejt në kapitalin e vet, sepse lidhet me transaksione që njihen gjithashtu, në të njëjtën ose një periudhë tjetër, në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse ose drejtpërdrejt në kapitalin e vet.

Tatimi aktual është tatimi i pritur i per tu paguar mbi të ardhurat e tatueshme të vitit, duke përdorur normat e tatimit të miratuara në datën e raportimit financiar, dhe çdo rregullim të tatimeve të pagueshme nga vitet paraardhëse. Fitimet ose humbjet e tatueshme bazohen në vlerësimin nëse pasqyrat financiare janë aprovuar para dorezimit të deklarates tatimore. Taksat e tjera qe nuk jane tatimi mbi fitimin, regjistrohen edhe si shpenzimete tjera administrative.

### 2.19 Tatimi mbi të ardhurat

Tatimi i shtyrë mbi të ardhurat njihet, në bazë të metodës së detyrimeve, si diferencë e përkohshme e krijuar midis bazës së aktiveve dhe detyrimeve dhe vlerës së mbetur të tyre në pasqyrat financiare. Megjithatë, tatimi i shtyrë nuk llogaritet nëse vjen si diferencë e vlerës fillestare të njohur të aktiveve apo detyrimeve përgjatë një transaksioni dhe jo nga kombinimi i bizneseve, kur ky transaksion nuk ndikon as në kontabilitet as në fitimin apo humbjet nga tatimi.

Tatimi i shtyrë për diferencat e përkohshme të zbritshme dhe humbja tatimore që mbartin përpara regjistrohen vetëm në atë masë sa është e mundshme që diferenca e përkohshme do të kthehet në të ardhmen dhe ka një fitim të mjaftueshëm të tatueshëm të ardhshëm të disponueshëm kundër të cilit zbritjet mund të përdoren.

Të drejtat dhe detyrimet e tatimit mbi të ardhurat e zhvlerësuara kompensohen kur ekziston një e drejtë e zbatueshme me ligj për të kompensuar aktivet tatimore korente ndaj detyrimeve tatimore aktuale dhe kur aktivet dhe detyrimet e tatimit mbi të ardhurat e shtyra lidhen me taksat e të ardhurave të vendosura nga i njëjti autoritet tatimor ku ka qëllim të shlyejë balancat mbi baza neto.

### 2.20 Pozicioni i pasigurt tatimor

Pozicionet e pasigurta tatimore të Shoqerise rivlerësohen nga menaxhimi në fund të çdo periudhe raportimi. Detyrimet regjistrohen për pozicionet e tatimit mbi të ardhurat, të cilat përcaktohen nga menaxhimi si më shumë të ngjarë që të mos sjellin tatime shtesë nëse pozicionet do të kundërshtoheshin nga autoritetet tatimore. Vlerësimi bazohet në interpretimin e ligjeve tatimore që janë miratuar në mënyrë thelbësore deri në fund të periudhës së raportimit, dhe njihen nga çdo gjykatë ose insitucione të tjera për çështje të tilla.

Detyrimet për gjobat, interesin dhe taksat e ndryshme nga të ardhurat njihen bazuar në vlerësimin më të mirë të menaxhimit të shpenzimeve të kërkuara për shlyerjen e detyrimeve në fund të periudhës së raportimit. Rregullimet për pozicionet e pasigurta të tatimit mbi të ardhurat, përveç interesit dhe gjobave, regjistrohen brenda tarifës së tatimit mbi të ardhurat. Rregullimet për pozicionet e pasigurta të tatimit mbi të ardhurat në lidhje me interesin dhe gjobitjet regjistrohen brenda kostove të financave dhe fitimeve të tjera / (humbjeve), përkatësisht neto.

### 2.21 Tatimi mbi vlerën e shtuar

Tatimi mbi vlerën e shtuar si rezultat i shitjeve i paguhet autoriteteve tatimore në momentin më të hershëm midis (a) mbledhjes së arkëtimeve nga klientët dhe (b) dërgimit të mallrave ose shërbimeve për klientët. TVSH-ja e hyrjes në përgjithësi mund të rikuperohet ndaj TVSH-së së prodhimit pas pranimit të faturës së TVSH-së. Autoritetet tatimore lejojnë shlyerjen e TVSH-së në bazë neto. TVSH-ja në lidhje me shitjet dhe blerjet njihet në pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar mbi bazën neto. Kur është bërë provizion për ECL të arkëtueshme, humbja nga zhvlerësimi regjistrohet për shumën bruto të debitorit, përfshirë TVSH-në.

### 2.22 Parapagimet

Parapagimet barten me kosto minus provizion për zhvlerësim. Një parapagim klasifikohet si jo-aktual kur mallrat ose shërbimet në lidhje me parapagimin pritet të merren pas një viti, ose kur parapagimi lidhet me një aktiv, i cili vetë do të klasifikohet si jo-aktual pas njohjes fillestare. Parapagimet për të marrë aktive transferohen në vlerën kontabël të aktivit pasi shoqerisa të ketë marrë kontrollin e aktivit dhe ka të ngjarë që përfitimet e ardhshme ekonomike të lidhura me aktivin të hyjnë në shoqeri. Parapagimet e tjera shlyhen në fitim ose humbje kur merren shërbimet në lidhje me parapagimet. Nëse ekziston një tregues se aktivet, mallrat ose shërbimet në lidhje me një parapagim nuk do të merren, vlera kontabël e parapagimit është shkruar në përputhje me rrethanat dhe një humbje përkatëse nga zhvlerësimi njihet në fitim ose humbje për vitin.

### 2.23 Provizione për detyrime dhe tarifa të tjera

Provizionet për detyrime dhe tarifa janë detyrime jo-financiare me kohën ose shumën e pasigurt. Ato vlerësohen kur Shoqeria ka një detyrim ligjor ose konstruktiv aktual si rezultat i ngjarjeve të kaluara, ka të ngjarë që do të kërkohet një rrjedhje burimesh që mbajnë përfitime ekonomike për të shlyer detyrimin, dhe një vlerësim i besueshëm i shumës së detyrimit mund të behet.

Provizionet maten me vlerën aktuale të shpenzimeve që pritet të kërkohen për të shlyer detyrimin duke përdorur një normë para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën kohore të parasë dhe rreziqet specifike të detyrimit. Rritja e provizionit për shkak të kalimit të kohës njihet si shpenzim interesi brenda kostove financiare.

Detyrimet dhe tarifat, siç janë taksat, përveç tatimit mbi të ardhurat ose tarifat rregullatore, të bazuara në informacione që lidhen me një periudhë para se të lind detyrimi për të paguar, njihen si detyrime kur ndodh ngjarja detyruese që shkakton pagimin e një tatimi, siç përcaktohet nga legjislacioni që shkakton detyrimin për pagimin e taksës. Nëse një taksë paguhet para ngjarjes detyruese, ajo njihet si parapagim.

### 2.23 Detyrimet e qirase

Shoqeria vlerëson në fillimet e kontratës nëse një kontratë është, ose përmban, një qira. Kjo do të thotë, nëse kontrata përcjell të drejtën për të kontrolluar përdorimin e një aktivi të identifikuar për një periudhë kohe në këmbim të vlerësimit. Shoqeria aplikon nje qasje te vetme per njohjen dhe matjen e te gjitha qirave, pervec qirave afatshkurtra dhe qirave me vlere te vogel.

## 3. Vlerësimet dhe Gjykimet Kritike të Kontabilitetit në Zbatimin e Politikave të Kontabilitetit

Shoqëria bën vlerësime dhe supozime që ndikojnë në shumat e njohura në pasqyrat financiare dhe vlerat kontabël të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar. Vlerësimet dhe gjykimet vlerësohen vazhdimisht dhe bazohen në përvojën e menaxhimit dhe faktorë të tjerë, përfshirë pritjet e ngjarjeve të ardhshme për të cilat besohet se janë të arsyeshme në rrethana. Menaxhimi gjithashtu bën gjykime të caktuara, përveç atyre që përfshijnë vlerësime, në procesin e zbatimit të politikave të kontabilitetit.

Gjykimet që kanë efektin më të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare dhe vlerësimet që mund të shkaktojnë një rregullim të rëndësishëm të vlerës kontabël të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar përfshijnë:

Shoqeria bën vlerësime dhe supozime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet e llogaritjes rezultuese, përkufizimi, rrallë janë te barabarta me rezultatet aktuale të lidhura. Vlerësimet dhe supozimet që kanë një rrezik të konsiderueshëm për të shkaktuar një rregullim material të vlerës kontabël të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar janë të përshkruara më poshtë.

### 4. Humbja e pritshme e kredisë

Shoqeria zbaton SNRF 9 qasjen e thjeshtuar për të matur humbjet e pritshme të kredisë, i cili përdor një kompensim për humbjet e pritshme gjatë gjithë jetës për të gjitha qirate financiare. Per matjen e humbjes se pritshme, te arketueshmet nga qiraja financiare janë grupuar bazuar në karakteristikat e përbashkëta të rrezikut të kredisë dhe ditët e kaluara. Normat e pritshme te humbjes jane bazuar në profilet e pagesave të shitjeve gjatë një periudhe kohe dhe humbjet përkatëse historike të kredisë sipas asaj periudhe. Normat historike te humbjeve jane rregulluar per te pasqyruar informacionin aktual dhe te ardhshem te faktoreve makroekonomik qe ndikojne në aftësinë e klientëve për të shlyer detyrimet.

Një rritje ose ulje prej 10% e përvojës aktuale të humbjeve krahasuar me vlerësimet e përdorura të humbjeve do të rezultonte në një rritje ose ulje të humbjeve nga zhvlerësimi i kredisë. Humbjet nga zhvlerësimi për kreditë individuale të rëndësishme bazohen në vlerësimet e flukseve monetare të zbritura të ardhshme të kredive individuale, duke marrë parasysh ripagimet dhe realizimin e çdo aktivi të mbajtur si kolateral ndaj kredive.

### 5. Mjetet monetare

**Mjete monetare**

| | 31 Dhjetor 2023 | 31 Dhjetor 2022 |
|---|---|---|
| Vlera monetare në bankë , në lekë | 60,822 | 55,127 |
| Vlera monetare në bankë , në monedha të huaja | 792,511 | 724,950 |
| Vlera monetare në arkë , në lekë | 1,879,793 | |
| **Total** | **2,733,126** | **780,077** |

Mjetet monetare perfaqesojne gjendje e mjeteve monetare qe shoqeria ka gjendje ne arke dhe ne llogarite bankare me 31 Dhjetor.
Mjete monetare ne EUR jane rivleresuar me kursin e kembit te dates 31 Dhjetor 1 Eur = 103.88 ALL.
Shoqeria nuk ka llogari ne monedha te tjera pervec se EUR.

### 7. Kerkesa te arketueshme

| | 31 Dhjetor 2023 | 31 Dhjetor 2022 |
|---|---|---|
| Llogari te arketueshme | 29,222,794 | 1,901,486 |
| Total | 29,222,794 | 1,901,486 |

Llogarite e arketueshme ne fund te vitit perfaqesojne te drejtat qe ka shoqeria ndaj klienteve per shitjet e realizuara ne lidhje me qerane financiare dhe qe ende nuk jane likujduar deri me 31 dhjetor.

## 8. Llogari te tjera te arketueshme

| | 31 Dhjetor 2023 | 31 Dhjetor 2022 |
|---|---|---|
| TVSH e arkëtueshme | 11,538,581.00 | 13,353,987.00 |
| Tatim fitimi | | 380,849.00 |
| Te tjere debitore | - | 4,413,053.00 |
| **Total** | **11,538,581** | **18,147,889** |

## 9. Te drejta te tjera afatshkurtra

Te drejtat ndaj ortakeve per kapital I nenshkruar I papaguar perfaqeson te drejtat ndaj ortakeve per kapitalin e regjistruar por ende te papaguar prej tyre ne daten e mbylljes se pasqyrave financiare.

| | 31 Dhjetor 2023 | 31 Dhjetor 2022 |
|---|---|---|
| Kapital I nenshkruar I papaguar | 40,000,000 | 40,000,000 |
| **Total** | **40,000,000** | **40,000,000** |

## 10. Te drejta te arketueshme nga qiraja financiare.

| | 31 Dhjetor 2023 | 31 Dhjetor 2022 |
|---|---|---|
| Te drejta arketueshme nga qiraja financiare | 197,869,315 | 280,445,109 |
| Provizione per te drejtat nga qerate financiare | (2,243,860) | |
| **Total** | **195,625,455** | **280,445,109** |

Te drejta te arketueshme nga qiraja financiare paraqet ne bilanc vleren e financimeve te realizuara per kliente te qerase financiare te cilat ende nuk jane bere te arketueshme me 31 Dhjetor.

## 11. Detyrime ndaj institucioneve te kredise.

| | 31 Dhjetor 2023 | 31 Dhjetor 2022 |
|---|---|---|
| Kredi te marra nga institucione jo bankare ASH | 51,940,000 | 57,115,000 |
| OVD OTP | 377,101 | 4,458 |
| **Total** | **52,317,101** | **57,119,458** |

Ne kete ze te pasqyrave financiare paraqitet detyrimi qe ka shoqeria per nje financim te marre ne vleren 500'000 eur si dhe gjendja OVD e llogarise ne OTP Bank me date 31 Dhjetor.

## 12. Llogari te pagueshme afatgjata ( detyrime tregtare )

| | 31 Dhjetor 2023 | 31 Dhjetor 2022 |
|---|---|---|
| Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit | 11,936,886 | 15,583,856 |
| Parapagime të marra | 16,686,832 | - |
| **Total** | **28,623,718** | **15,583,856** |

Llogarite e pagueshme perfaqesojne detyrime te qerase financiare te cilat jane bere te pagueshme ose detyrime ndaj furnitoreve per lloje te tjera furnizimesh.
Nderkohe qe llogari parapagime te marra paraqet vleren e parapagimeve te arketuara ose per te cilat jane leshuar fatura parapagimi por nuk jane leshuar ende faturat e shitjes.

## 13. Të pagueshme për detyrime tatimore

| | 31 Dhjetor 2023 | 31 Dhjetor 2022 |
|---|---|---|
| Detyrim per Sigurimet Shoqerore & Shendetsore | 286,003 | 250,470 |
| Tatimi mbi fitimin | 525,581 | |
| **Total** | **811,584** | **250,470** |

## 14. Të pagueshme ndaj punonjësve

| | 31 Dhjetor 2023 | 31 Dhjetor 2022 |
|---|---|---|
| Të pagueshme ndaj punonjësve | 307,283 | 63,017 |
| **Total** | **307,283** | **63,017** |

## 15. Të tjera detyrime afatshkurtra

| | 31 Dhjetor 2023 | 31 Dhjetor 2022 |
|---|---|---|
| Debitore te tjere | 75,635.00 | 75,635.00 |
| Detyrime ndaj ortakeve | 6,554,632 | |
| **Total** | **6,630,267** | **75,635** |

Ne vitin 2023 shoqeria eshte financuar ne vleren 5'500'000 lek nga Znj. Kestrina Budina.
Ne vitin 2024 ky detyrim eshte likujduar kundrejt emetimit te kuotave te kapitalit.

## 16. Detyrime financiare afatgjata

| | 31 Dhjetor 2023 | 31 Dhjetor 2022 |
|---|---|---|
| Detyrime te pagueshme per qera financiare AGJ | 117,369,337 | 197,406,933 |
| **Total** | **117,369,337** | **197,406,933** |

Detyrimet financiare afatgjata paraqesin vleren e detyrimeve per qera financiare qe shoqeria ka me daten 31 Dhjetor te cilat nuk jane bere ende te pagueshme.

## 17. Kapitali dhe Rezervat

**Kapitali dhe Rezervat**

| | 31 Dhjetor 2023 | 31 Dhjetor 2022 |
|---|---|---|
| Kapitali i Regjistruar I paguar | 23,461,684 | 23,461,684 |
| Kapital I regjistruar I papaguar | 40,000,000 | 40,000,000 |
| Fitimi i pashpërndarë | (1,686,492) | (2,404,876) |
| Fitim (humbja) e vitit | 2,285,474 | 718,384 |
| **Totali I Kapitalit** | 64,060,666 | 61,775,192 |
| | - | - |

Kapitali dhe rezervat paraqiten si me lart. Shoqeria ne vitin 2022 eshte financuar ne vleren 9'000'000 lek nepermjet nje kontrate huaje ne formen e borxhit te varur. Kapitali sipas formatit te raportimit ne Banken e Shqiperise paraqitet si me poshte:

**Kapitali dhe Rezervat**

| | 31 Dhjetor 2023 | 31 Dhjetor 2022 |
|---|---|---|
| Kapitali i Regjistruar I paguar | 23,461,684 | 23,461,684 |
| Kapital I regjistruar I papaguar | 40,000,000 | 40,000,000 |
| Fitimi i pashpërndarë | (1,686,492) | (2,404,876) |
| Fitim (humbja) e vitit | 2,285,474 | 718,384 |
| Borxh I Varur | 9,000,000 | 9,000,000 |
| **Totali I Kapitalit** | **73,060,666** | **70,775,192** |

## 18. Te ardhurat dhe shpenzimet nga qiraja financiare.

Rezultati neto nga aktiviteti i qerase financiare paraqitet si me posht:

| | Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2023 | Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2022 |
|---|---|---|
| Te ardhura nga interesat | 16,481,898 | 9,607,553 |
| Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme | (9,487,847) | (6,836,900) |
| **Total** | **6,994,051** | **2,770,653** |

## 19. Të ardhura dhe shpenzime te tjera nga aktiviteti shfrytezimit

| | Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2023 | Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2022 |
|---|---|---|
| Te ardhurat nga rifaturim primi dhe komisionet disbursimit | 9,863,892 | 15,310,499 |
| Shpenzime nga rifaturim primi | (7,314,800) | (6,846,147) |
| **Total** | **2,549,092** | **8,464,352** |

ANTIGONE FINANCIAL ENTERPRISE M01329024A TIRANA - ALBANIA

## 20. Shpenzime page

| | Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2023 | Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2022 |
|---|---|---|
| Pagat | (7,393,387) | (8,297,859) |
| Shpenzimet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore | (979,450) | (981,608) |
| **Total** | **(8,372,837)** | **(9,279,467)** |

Shpenzimet e personelit perbehen nga shpenzimet per paga dhe shpenzimet per sigurimet e detyrueshme shoqerore sipas kerkesave te legjislacionit ne fuqi.

## 21. Shpenzime të tjera administrative

| | Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2023 | Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2022 |
|---|---|---|
| Shpenzime te ndryshme | | (781,789) |
| Mirembajtje dhe riparime | (13,067) | |
| Shpenzime per sigurime | (1,891,465) | (2,396,061) |
| Pagesa te ndermjetësve dhe honorare | | (249,225) |
| Sherbime bankare | (241,357) | (68,778) |
| Taksa vendore | (15,500) | (15,500) |
| Gjoba dhe penalitete | (141,506) | |
| Penalitete per shlyerje me vonese | (2,152,069) | |
| Shpenzime te tjera | -268,356.00 | -430,474.00 |
| **Total** | **(4,723,320)** | **(3,941,827)** |

Shpenzimet e administrimit detajohen si me lart.
Ne vitin 2023 shoqeria kishte detyrimin per te shlyer nje kredi ne vleren 500'000 eur ,per mosshlyerjen e se ciles ka paguar nje penalitet ne vleren 2,152,069 lek i cili eshte raportuar ne shpenzimet e panjohura per efekte fiskale.

## 22. Shpenzimet per provizione per vitin 2023 paraqiten si me poshte:

| | |
|---|---|
| **Shpenzime per provigjione** | (2,243,860) |

## 23. Rezultati nga kembimi valutor neto

| | Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2023 | Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2022 |
|---|---|---|
| Fitim nga kembimet valutore | 34,846,976 | 15,941,266 |
| Humbje nga kembimet valutore | (25,858,198) | (13,236,593) |
| Total | 8,988,778 | 2,704,673 |

ANTIGONE FINANCIAL ENTERPRISE TIRANA ALBANIA

## 24. Tatim fitimi

Norma e tatim fitimit të aplikueshem mbi të ardhurat e shoqerise për vitin 2023 është 15% (2022: 15%). Në pasqyrat financiare të Shoqërisë, aktivet dhe detyrimet njihen në të njëjtën masë mbi bazën e tyre kontabël dhe të tatueshme. Dallimet që mund të lindin janë të përhershme, prandaj Shoqeria nuk vlerëson ndonjë tatim te shtyrë.

| | Norma e Tatimit | 2023 | Norma | 2022 |
|---|---|---|---|---|
| Fitim/humbja para tatimit | 15% | 3,191,904 | 15% | 718,384.00 |
| Llogaritja me normën 15% | 15.00% | 478,785.60 | 15.00% | 107,757.60 |
| | | | | |
| | | | | |
| | | | | |
| **Fitim/humbja para tatimit** | **15%** | **3,191,904** | **15%** | **718,384.00** |
| Shpenzime të panjohura për qëllime tatimore | | 4,537,435.00 | | - |
| Fitim humbje te mbartura | | (1,686,492) | | (2,404,876.00) |
| **Fitimi I tatueshem** | | **6,042,847.00** | | - |
| Llogaritja me normën 15% | 15% | 906,427.05 | -15.00% | - |
| **Norma efektive tatimore** | | **28%** | | **0%** |

## 25. Angazhime dhe detyrime te kushtezuara

Gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë, ndaj Shoqërisë mund të ngrihen padi. Në bazë të vlerësimeve të kryera vetë dhe duke u mbështetur mbi këshillat e brendshme dhe te jashtme profesionale, drejtimi është i mendimit se asnjë humbje e rëndësishme nuk do të ndodhë në lidhje me këto padi dhe për këtë arsye asnjë provizion nuk është njohur në këto pasqyra financiare.

## 26. Ngjarjet pas datës së raportimit

Nuk ka asnje ngjarje te mepasshme pas dates se raportimit e cila kerkon rregullime apo shpjegime ne keto pasqyra financiare.